



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 55 regjistër (JR)
Datë 27.12.2024

Nr. 9 i vendimit
Datë 28.01.2026

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Ina Rama	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 28.01.2026, ditën e mërkurë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Lazer Çardaku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 812, datë 08.11.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Lazer Çardaku.

BAZA LIGJORE: Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Aneksi i Kushtetutës, nenet A-G; Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 5, pika 2 dhe 63; Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; Jurisprudenca e GjEDNj-së dhe e Gjykatës Kushtetuese; Opinionet e Komisionit të Venecias për Shqipërinë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 812,

datë 08.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Lazer Çardaku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e prokurorit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, *ex officio*.
Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me shkresën nr. {***} prot., datë 20.10.2025, i ka njoftuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit vendimin nr. {***}, datë 10.10.2025, nëpërmjet të cilit është vendosur pranimi i kërkesës dhe miratimi i qëndrimit në detyrë të magjistratit Lazer Çardaku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, deri në mbushjen e moshës 70 vjeç.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim “AKSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), dhe pas përfundimit të hetimit administrativ ka vendosur si vijon.
 - i) Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë: *“Mbështetur në rrethanat e faktit dhe të dhënat e mbledhura gjatë hetimit, si dhe provat shkresore të administruara në dosje lidhur me kriterin e vlerësimit pasuror, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: (i) ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë; (ii) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) ka kryer deklaram të rremë të pasurisë, duke u vendosur në kushtet parashikuara sipas leximit acontrario të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, shkronjat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.*
 - ii) Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës: *“Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Lazer Çardaku, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016”.*
 - iii) Lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: *“Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, denoncimeve të depozituara nga publiku, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se*

në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, të kërkuar nga ligji nr. 84/2016”.

iv) Lidhur me vlerësimin tërësor të çështjes: “Në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në nenin 4, pika 2 dhe nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, pasi: (i) në deklaratën e rivlerësimit kalimtar vetting ka kryer deklaram të rremë për vlerën e blerjes së apartamentit + shtesës anësore në Shkodër, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të hetimit, duke mosdeklaruar përdorimin e një pasurie të paluajtshme – pas dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar Vetting, në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016; (iii) nuk ka deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar vetting përdorimin prej tij apo personave të lidhur të pasurisë së llojit automjet, në shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016; (iv) ka përdorur një automjet në pronësi të një shtetasi tjetër për një periudhë të gjatë kohore pakundërshpërblim dhe pa dokumentacion justifikues ligjor”.

II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit

3. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), më datë 19.12.2024, protokolluar në Komision me nr. {***} prot., kundër vendimit nr. 812, datë 08.11.2024, të Komisionit. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet të cilit kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 812, datë 08.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e tij në detyrë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka bashkëlidhur ankimit akte shkresore për t’u administruar në cilësinë e provës nga trupi gjykues.

Shkaqet procedurale të ankimit

3.1 Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit është marrë si rrjedhojë e një procesi të parregullt ligjor, i cili konsiston në disa elemente, si vijojnë.

(i) Komisioni nuk ka arritur që të ruajë paanësinë dhe pavarësinë e tij, duke iu nënshtruar një paracaktimi të vendimit që do merrej ndaj subjektit.

(ii) Subjekti pretendoi se i është mohuar e drejta për t’u dëgjuar, pasi Komisioni ka administruar vetëm formalisht provat dhe shpjegimet, por nuk i ka analizuar ato.

(iii) Subjekti pretendon se procesi administrativ i zhvilluar ndaj tij është *nul* për shkak të mungesës së arsytimit në standarde të pranueshme të vendimit përfundimtar.

(iv) Subjekti, gjithashtu, pretendoi se nuk i është garantuar parimi i proporcionalitetit dhe objektivitetit, duke e lidhur këtë me periudhën e vlerësimit të pasurisë.

Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

3.2 Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 73 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, si dhe shtesën e ndërimit me sip. 22,9 m² së bashku me truallin, të ndodhur në të njëjtën adresë, subjekti ka pretenduar se vlera e tregut e deklaruar në vitin 2003, nuk nënkupton se çmimi i blerjes së këtyre pronave në vitin 1999 ka qenë 2.400.000 lekë.

¹ “Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelineve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit”.

Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni për blerjen e kësaj pasurie, pasi pretendon t'i ulen shpenzimet jetike për shkak të jetesës në fshat, e cila është ndihmuar nga prodhimet bujqësore. Subjekti ka kërkuar që shpenzimet jetike për këtë periudhë të jenë më të ulëta, në nivelin e 30-40% të të ardhurave, çka do të sillte një bilanc pozitiv në analizën financiare për periudhën 1992-1999, sidomos për blerjen e kësaj pasurie.

3.3 Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf 5”, me targë {*}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka gabuar duke mos njohur huanë e marrë nga djali i tij për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se mosdeklarimi i përdorimit sporadik i këtij mjete të moskonsiderohet si një shkelje, e aq më pak si një shkak për shkarkimin e tij nga detyra.**

3.4 Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Lupo”, me targë {*}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka gabuar që ka vlerësuar një pasuri që nuk e posedon më dhe që nuk ka shërbyer si burim për blerjen e një pasurie tjetër, aq më tepër për vlera të papërfillshme, siç është në rastin konkret, që përkon me gjysmën e rrogës mujore.**

3.5 Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 48,5 m², ndodhur në {*}, Shkodër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar, në ankim, se Komisioni ka gabuar që nuk ka konsideruar në vitin 1999 përfitimin e të ardhurave nga shitja e këtij apartamenti, duke mosrespektuar parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Subjekti argumenton sa i përket mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, si dhe atë periodike të vitit 2005, megjithëse e pranon se formalisht ka qenë një e metë për shkak të mospasjes së qartë të mënyrës së deklarimit të pasurive, një fakt i tillë nuk duhet të afektojë procesin e tij të rivlerësimit, pasi objekt i kontrollit të tyre nuk janë deklaratat periodike, por deklaratat *vetting*, në të cilën sqaron se e ka deklaruar rregullisht, përfshirë shitjen e saj.**

3.6 Lidhur me automjetin tip “Opel Moka”, me targë {*}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka dalë jashtë funksionit të tij në hetimin, analizimin dhe përfundimet në lidhje me këtë pasuri, pasi ajo nuk i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar. Subjekti pretendon se nuk e ka fshehur përdorimin e këtij mjete, por sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikave ligjore nuk e ka pasur një detyrim ligjor deklarimin e përdorimit të këtij mjete në DIPP-në e vitit 2023. Subjekti, gjithashtu, pretendon se është krejtësisht i pabazuar dhe abuziv përfundimi i Komisionit për cenim të figurës së prokurorit, duke pasjellë cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë pa analizuar se cilat janë veprimet e tij që përbëjnë këtë cenim të besimit të publikut.**

3.7 Lidhur me denoncimin për pasuri të fshehur në zonën e plazhit të Velipojës, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mënyra e zhvillimit të hetimit nga Komisioni për këto denoncime anonime tregon për anshmërinë dhe paragjykimin e Komisionit me qëllim gjetjen me çdo kusht të një shkakut për ta shkarkuar nga detyra. Subjekti sqaron se bindja e Komisionit se e ka përdorur apartamentin në Velipojë pakundërshtëpërblim, nuk ka cilësinë provuese të kërkuar nga ligji nr. 84/2016, nenet 41 dhe 49-51 të tij.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

4. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Lazer Çardaku, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

5. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

6. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit kryhet në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) vlerësoi në fillim të analizojë shkaqet procedurale të ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të vlerësuar nëse ndodhemi në kushtet e nenit 51 pika 1 e ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, në konsideratë edhe të faktit që subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte shpresore, sipas nenit 47 të po këtij ligji, për t’u administruar në cilësinë e provës nga trupi gjykues.

Vlerësimi i trupit gjykues mbi shkaqet procedurale të ankimit

7. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se Komisioni nuk ka arritur që të ruajë paanësinë dhe pavarësinë e tij, pasi ka paracaktuar vendimin që do merrej ndaj tij. Subjekti pretendon se Komisioni në vijimësi gjatë hetimit administrativ ka shfaqur haptazi anshmërinë e tij, duke mbajtur qëndrime paragjyqëse dhe tendencioze ndaj figurës dhe personalitetit të subjektit në kundërshtim me provat që dispononte. Subjekti pretendon se është trajtuar në mënyrë diskriminuese nga Komisioni dhe ndryshe nga shumë subjekte të tjerë rivlerësimi. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se barazia në ligj dhe para ligjit, e trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllajta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia në ligj dhe para ligjit presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta. Gjykata Kushtetuese është shprehur në vendimet e saj se neni 18 i Kushtetutës, para së gjithash, sanksionon një detyrim negativ, sipas së cilit

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

shteti duhet të mosndërhyjë, me qëllim që askush të mosdiskriminohet padrejtësisht. Ky interpretim buron nga vetë natyra e parimit të barazisë përpara ligjit, të sanksionuar në Kushtetutë, që nënkupton të drejtën për t'u trajtuar në mënyrë të barabartë, duke u mbrojtur nga diskriminime të pambështetura në një përlligje të arsyeshme dhe objektive.

Trupi gjykues sjell në vëmendje se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar nga Komisioni subjektet e tjera të rivlerësimit. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar me vendimmarrje³ të mëparshme të tij.

8. Subjekti pretendon se i është mohuar e drejta për t'u dëgjuar, pasi Komisioni ka administruar vetëm formalisht provat dhe shpjegimet, por nuk i ka analizuar ato. Subjekti pretendon se edhe në vendimin përfundimtar në shumë momente nuk janë paraqitur argumentet dhe prapësimet e tij ose janë paraqitur pa i analizuar, duke iu shprehur me një frazë shabllon se *Komisioni nuk i vlerëson ato bindëse*. Trupi gjykues vlerëson se në vendimin e Komisionit evidentohet se është kryer një analizë e provave, të cilat janë shqyrtuar për vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Rezulton se për secilën pasuri të hetuar, janë marrë në konsideratë shpjegimet dhe pretendimet e subjektit, duke i cituar ato në arsyetimin e vendimit. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, shpjegimet dhe aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve dhe të rezultateve të hetimit pas kalimit të barrës së provës, janë administruar nga Komisioni dhe asnjë prej këtyre akteve nuk është refuzuar, por i janë nënshtruar vlerësimit të Komisionit, sipas gjetjeve respektive, duke i dhënë vlerën provuese që Komisioni ka çmuar sipas diskrecionit të tij. Sa më sipër, nuk u evidentuan të dhëna, sipas së cilave procesi i zhvilluar në Komision të mos ketë marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, kështu që, pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i argumentuar lidhur me këtë shkak ankimi.
9. Subjekti pretendon se procesi administrativ i zhvilluar ndaj tij është *nul* për shkak të mungesës së arsyetimit të vendimit përfundimtar, mbështetur në standarde të pranueshme, pasi gjatë leximit të tij arrihet në përfundimin se është thelbësisht i paarsyetuar. Subjekti sjell në vëmendje se përmes arsyetimit të vendimit, gjykata duhet të arrijë të përmbushë detyrimin e saj për të bindur palët se dispozitivi i vendimit të saj nuk është thjesht shprehje e vullnetit të gjyqtarëve pjesë të trupit gjykues, por rezultat logjik dhe ligjor i provave të marra në gjykim. Trupi gjykues sjell në vëmendje nenin 42 të Kushtetutës dhe jurisprudencën e konsoliduar të Gjykatës Kushtetuese, sipas së cilës e drejta e individit për një proces të rregullt ligjor nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 08.12.2005 (kriteret e arsyetimit të vendimit gjyqësor), ka arsyetuar se: *“Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshëm për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese [...]”*. Gjithashtu, në nenin 142, pika 1 e Kushtetutës së

³ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 11/2021 (JR), datë 31.03.2021 dhe nr. 8/2022 (JR), datë 07.04.2022.

Republikës së Shqipërisë, parashikohet qartë detyrimi i gjykatave për të arsyetuar çdo vendim gjyqësor që jepet prej tyre. Kodi i Procedurës Civile në nenet 306-310 përcakton rregulla të qarta për formën, përmbajtjen e vendimeve gjyqësore, si dhe mënyrën e dhënies së vendimit e formën e tij. Një vendim i ardhur si fryt i një arsytimi të plotë dhe të kuptueshëm ndikon në forcimin e vetë sistemit gjyqësor dhe gjeneron besim ndaj tij në sytë e publikut të gjerë. Vendimet përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë. Lidhur me rastin konkret, rezulton se Komisioni administroi të gjitha provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, prova të cilat gjenden të materializuara në funksion të arsytimit të vendimit objekt shqyrtimi. Trupi gjykues vlerëson se vendimi i Komisionit është arsyetuar në përputhje me standardet e kërkuara nga Gjykata Kushtetuese dhe, si rrjedhojë, e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se vendimi objekt shqyrtimi është i paarsyetuar.

10. Subjekti i rivlerësimit pretendon, gjithashtu, se brenda kriterit të pasurisë, për të cilin është shkarkuar nga detyra, analizat dhe interpretimet e kryera nga Komisioni nuk janë objektive, duke u fokusuar në kundërshtimin e mundësive ekonomike të një kohe të largët, për të cilën nuk ka asnjë mundësi objektive për të gjetur dokumentacion shkresor, duke cenuar në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike. Subjekti sqaron se në respektim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, duke njohur shkallën e lartë të informalitetit në vendin tonë, ligjvënësi ka vendosur që gjatë procesit të rivlerësimit të sanksionojë standardin e moslejimit të justifikimit më shumë se të dyfishit të pasurisë së ligjshme të dokumentuar. Subjekti pretendon se në rastin e tij Komisioni nuk e ka cekur fare një garanci të tillë, por interpretimi i tij ka shkuar aq larg, sa jo vetëm nuk i referohet të ardhurave të ligjshme, por nuk ka njohur as këto të ardhura si të kursyera, duke i konsideruar ato si të shpenzuara për jetesë. Trupi gjykues vlerëson se analiza e këtij shkaku ankimi do trajtohet në mënyrë të integruar në kuadër të shkaqeve që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit.
11. Trupi gjykues, në analizë sa më sipër, lidhur me shkaqet procedurale të ankimit në kuadër të procesit të rregullt ligjor të kryer në Komision, lidhur dhe me sigurimin e garancive kushtetuese dhe ligjore për subjektin e rivlerësimit përgjatë hetimit administrativ, çmon që gjykimi i kësaj çështjeje të vijojë në dhomë këshillimi, bazuar në nenin 49 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, pasi nuk gjendemi në asnjë prej rasteve të parashikuara nga neni 51, pika 1 e po këtij ligji.

Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

12. Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 73 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, si dhe shtesën e ndërtimit me sip. 22,9 m² së bashku me truallin, të ndodhur në të njëjtën adresë, subjekti i rivlerësimit pretendon se vlera e tregut e deklaruar në vitin 2003 nuk nënkupton se çmimi i blerjes së këtyre pronave në vitin 1999 ka qenë në shumën 2.400.000 lekë. Subjekti sqaron se do ishte pa kuptim që nga njëra anë të deklaronte si çmim të blerjes së kësaj pasurie vlerën 2.400.000 lekë dhe nga ana tjetër të paraqiste bashkëlidhur si provë kontratën e blerjes së saj me vlerë 12 herë më të vogël se ajo e deklaruar. Në të njëjtën mënyrë janë deklaruar edhe pasuritë në vitin 2021, sqaron subjekti, ku përveç banesës 2+1 (deklaruar me vlerë 2.400.000 lekë), është deklaruar edhe për banesën shtëpi private në fshatin {***}, ndërtesë 3-katëshe me sipërfaqe trualli 95 m², deklaruar në vlerën 4.000.000 lekë apo për sipërfaqen prej 2.000 m² tokë arë, deklaruar në vlerën 1.000.000

lekë, ndërkohë që vlera e fitimit të këtyre pasurive⁴ është 0 (zero). Subjekti pretendon se Komisioni ka shpërfillur, jo vetëm vlerën ligjore të kontratës së blerjes, por edhe logjikën se vlera e një apartamenti parafabrikat në kat të parë, i ndërtuar shumë vite më parë dhe me nivel të lartë amortizimi, nuk mund të blihej akses në vitin 1999, njëlloj sa një apartament i ri që mund të ndërtohej nga EKB-ja në këtë vit me standard tjetër ndërtimi. Subjekti argumenton se një subjekt i të drejtës civile, në shprehje të lirisë kontraktore, mund ta dhurojë një send apo ta japë në përdorim pakundërshpërblim, aq më tepër të ketë liri ta shesë më lirë se sa janë referencat e një enti si EKB-ja apo çmimet e tregut. Subjekti pretendon se para se të blinte këtë apartament në Shkodër, ka shitur apartamentin në fshatin {***}, Shkodër, në vitin 1999, por kontrata e shitjes është formalizuar në vitin 2005 për shkak se njëri nga blerësit ndodhej jashtë vendit dhe nuk mund të paraqitej para noterit për të nënshkruar kontratën. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të kryer nga Komisioni për blerjen e kësaj pasurie, pasi pretendon t'i ulen shpenzimet jetike për shkak të jetesës në fshat, e cila është ndihmuar nga prodhimet bujqësore. Gjithashtu, pretendon se shpenzimet jetike për këtë periudhë duhet të jenë më të ulëta, në nivelin e 30-40% të të ardhurave, çka do të sillte një bilanc pozitiv në analizën financiare për periudhën 1992-1999, sidomos për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ka kryer deklaram të rremë për çmimin e blerjes së këtij apartamenti, pasi ky konkluzion vjen në kundërshtim të plotë me dokumentin provues, kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie.

12.1 Komisioni për këtë pasuri vlerëson se: *“Çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së datës 23.08.1999 nuk përfaqëson çmimin real të shitblerjes së dy pasurive objekt vlerësimi. Në këtë kontekst, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën vetting, lidhur me çmimin e blerjes së pasurive të llojit apartament banimi me sipërfaqe 73 m² dhe shtesës anësore me sipërfaqe 22,9 m², duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016. [...] Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

12.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje rezulton se në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklaram pasurie, e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi (2+1) me sipërfaqe 73 m², me vlerë 2.400.000 lekë, ndodhur në lagjen “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër, blerë në vitin 1999, me burim kursimet nga pagat, me pjesë takuese 100%.

- Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri të blerë në vitin 1999, me adresë: rruga “Stacioni i trenit”, Shkodër, me vlerë 2.000.000 lekë, me pjesë takuese 100%.

- Në DIPP-në e vitit 2012, ka deklaruar rivlerësimin e kësaj pasurie, shtëpi banimi në pallat me sipërfaqe 73 m², datë 21.03.2012. Vlera e këtij rivlerësimi është deklaruar nga subjekti në shumën 4.036.400 lekë. Deklaron se zotëron 50% pjesë takuese të kësaj pasurie.

12.3 Në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament banimi, me sipërfaqe 73 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, regjistruar me akt shitblerje pasurie të paluajtshme nr. {***}, datë 23.08.1999, në bashkëpronësi me bashkëshorten, blerë me çmimin 200.000 lekë. Gjithashtu, ka deklaruar se prona është rivlerësuar në datën 21.03.2012, në vlerën prej 4.036.900 lekësh.

⁴ Pasuri të trashëguara nga familjarët e origjinës së subjektit të rivlerësimit.

Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar kursimet prej të ardhurave nga paga për vitet 1982 deri në vitin 1992, si specialist në Kooperativën Bujqësore {***}, në detyrën e hetuesit dhe, më pas, të prokurorit në qytetin e Pukës, nga viti 1992 deri në vitin 1999, si edhe nga kursimet e pagës së bashkëshortes si mësuese.

12.4 Pasurinë e llojit ndërtesë/shtesë me sip. 22,9 m² së bashku me truallin, ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, në bashkëpronësi me bashkëshorten, regjistruar me leje legalizimi, subjekti e ka deklaruar në deklaratën *vetting* se është ngjitur me pallatin e banimit (kati parë) dhe se është bërë para vitit 1999, duke u blerë në atë gjendje së bashku me apartamentin objekt kontrolli në datën 23.08.1999, përfshirë në vlerën e blerjes së tij. Në vijim të deklaramit të tij, subjekti ka shpjeguar se me hyrjen në fuqi të ligjit për legalizimin e ndërtimeve pa leje është aplikuar për legalizimin e shtesës së apartamentit dhe në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 18.07.2012, kjo pasuri është regjistruar në pronësi të tij dhe të bashkëshortes. Vlera e investimit të shtesës është vlerësuar 670.764 lekë. Nga verifikimi i deklaratave të interesave private të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI, ka rezultuar se në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar legalizimin e shtesës së pallatit në sipërfaqen 22,9 m².

12.5 Nga dokumentacioni i administruar në dosje ka rezultuar se më datë 23.08.1999, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë blerë⁵ pasurinë e llojit apartament banimi me sipërfaqe 73 m², të ndodhur në lagjen “{***}”, rruga “{***}”, Shkodër, për çmimin prej 200.000 lekësh. Në datën 09.05.2012, subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar me Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t Shkodër kontratën⁶ e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore për truallin në të cilën ishte ndërtuar shtesa anësore pa leje, me sipërfaqe prej 22,9 m². Në datën 16.05.2012, nga kjo Drejtori është lëshuar Leja e Legalizimit për shtesën e deklaruar nga subjekti, me të dhënat: (i) sipërfaqja e parcelës ndërtimore 22,9 m²; dhe (ii) sipërfaqja e ndërtimit 22,9 m², nga të cilat për banim 22,9 m². Pasuritë objekt kontrolli (apartamenti me sip. 73 m² dhe shtesa anësore me sip. 22,9 m²) rezultojnë se janë regjistruar në regjistrat hipotekorë në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij.

12.6 Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime mbi mospërputhjet e evidentuara në deklaramin e bërë ndër vite dhe në deklaratën *vetting*, për vlerën e apartamentit të ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, si dhe të konfirmojë çmimin e blerjes së këtij apartamenti, duke deklaruar nëse ai përfshin edhe shtesën anësore apo nëse ka paguar vlerë tjetër për të. Në përgjigje, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vlera e banesës 2.400.000 lekë është deklaruar në referim të çmimeve të tregut për zonën në të cilën ndodhet banesa dhe nuk ka lidhje me vlerën e çmimit të blerjes së saj. Një fakt i tillë është deklaruar në deklaratën e interesave private periodike vjetore në formë elektronike në vitin 2021, ku përveçse banesës 2+1 (rezulton e deklaruar me vlerë 2.400.000 lekë), është deklaruar edhe për banesën shtëpi private në fshatin {***}, ndërtesë 3 katesh me sipërfaqe trualli 95 m², deklaruar në vlerën 4.000.000 lekë apo për sipërfaqen prej 2.000 m² tokë arë, deklaruar në vlerën 1.000.000 lekë, ndërkohë që vlera e fitimit të këtyre pasurive është (0) zero, pasi ato janë fituar nga trashëgimia. Këto vlera, sipas subjektit, përfaqësojnë vlerën e tregut ku ndodhen këto pasuri e jo çmimin e blerjes së tyre. Subjekti sqaron, gjithashtu, se referuar po kësaj deklarate (2021), është saktësuar se shtesa (e apartamentit) është e legalizuar dhe është blerë së bashku me apartamentin me sipërfaqe 73 m² në vitin 1999, në shumën 200.000 lekë. Çmimi i blerjes së banesës ka qenë 200.000 lekë, gjë të cilën e konfirmon akti i shitblerjes nr. {***}

⁵ Kontratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.1999.

⁶ Kontratë noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.05.2012.

rep., nr. {***} kol., datë 23.08.1999 dhe e regjistruar në certifikatën e pronësisë me nr. {***}, datë 15.01.2009, në bashkëpronësi me A. Ç. (bashkëshorten). Subjekti sqaroi se ndërtimi me sipërfaqe 22,9 m² ka qenë shtesë e banesës 2+1, apartamentit të blerë prej tij në datën 23.08.1999 dhe nuk është ndërtuar nga ai, por nga shitësi S. D. përpara se subjekti të blinte apartamentin së bashku me këtë shtesë.

12.7 Bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të deklaratimeve të tij, ka depozituar disa deklarata noteriale⁷, të cilat referon se janë bërë nga banorë të tjerë të këtij pallati që kanë banuar aty para blerjes së kësaj pasurie prej subjektit. Këto deklarata kanë objekt të njëjtë, sipas së cilave deklaruesit kanë qenë banorë të pallatit, ku ndodhet apartamenti dhe shtesa anësore, dhe deklarojnë se subjekti ka blerë apartamentin së bashku me shtesën anësore ngjitur pallatit ekzistues.

12.8 Në procesverbalin “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë”, datë 15.01.2016, përcjellë Komisionit nga ILDKPKI-ja, me shkresën me nr. {***} prot., datë 12.08.2024, lidhur me shtesën e apartamentit, subjekti ka deklaruar se ka qenë e ndërtuar rreth vitit 1998 dhe vlera e blerjes e deklaruar në shumën 2.400.000 lekë për apartamentin ka të përfshirë edhe këtë shtesë.

Për shkak të mospërputhjeve të evidentuara në deklaratimet e subjektit lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, Komisioni dyshoi se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes, datë 23.08.1999, nuk përfaqëson çmimin real të blerjes së këtyre dy pasurive. Për këtë arsye, Komisioni iu referua për krahasim VKM-së nr. 214, datë 28.04.1999, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “K””, sipas së cilit vlera mesatare e tregut të lirë të apartamenteve për rrethin e Shkodrës ka qenë 23.400 lekë/m². Sipas kësaj vlere, Komisioni konkludoi se vlera e apartamentit prej 73 m² në rrethin e Shkodrës ka qenë në shumën prej 1.708.000 lekësh (73 m² x 23.400 lekë/m² = 1.708.000 lekë). Sipas Komisionit, bazuar në deklaratimet e bëra prej subjektit për këto pasuri, ai ka pranuar se çmimi real i blerjes së apartamentit + shtesës anësore ka qenë në shumën 2.400.000 lekë.

12.9 Komisioni kreu analizën e treguesve financiare, me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit dhe personit të lidhur, bashkëshortes së tij, për pagesën në datën 23.08.1999 të çmimit të përlllogaritur prej 2.400.000 lekësh, për blerjen e pasurive objekt vlerësimi, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e pasurisë për një diferencë negative në shumën (-) 1.867.347 lekë dhe për këtë konstatim, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e asaj çfarë ka rezultuar.

12.10 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se deklarimi i vitit 2003 i përket vlerës së tregut për dy pasuritë (apartamenti + shtesa), ku në vlerësimin e tij apartamenti me sipërfaqe 73 m² kishte një vlerë tregu prej 2.000.000 lekësh dhe shtesa anësore prej 400.000 lekësh, ndaj për këtë arsye, në deklaratën e vitit 2003 ka deklaruar vlerën e tregut të këtyre dy pasurive, në shumën totale 2.400.000 lekë. Ndërsa, në vitin 2004 referon se ka deklaruar vetëm apartamentin në vlerën e tregut 2.000.000 lekë, duke mbajtur në konsideratë vetëm pasurinë e regjistruar, ndërsa për shtesën, për sa kohë nuk kishte dokumentacion justifikues ligjor, sqaron se kishin orientim që nuk duhej deklaruar. Sa i përket çmimit të vlerësuar nga Komisioni për blerjen e këtyre dy pasurive, subjekti ka shpjeguar se vlera mesatare e tregut të lirë të

⁷ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.08.2024; deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.08.2024; deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 12.08.2024.

apartamenteve për vitin 1998, sipas VKM-së nr. 214, datë 28.04.1999, i përket çmimit të apartamenteve të reja dhe jo apartamenteve parafabrikat, për shkak të cilësisë, por edhe të vendndodhjes së apartamentit afër stacionit hekurudhor. Gjithashtu, subjekti ka referuar faktin se kjo metodikë e Komisionit nuk është zbatuar në ato vite, pasi pretendon se po në vitin 1999 ai sqaron se ka shitur apartamentin me sipërfaqe 48,5 m², në shumën 200.000 lekë, ndërsa sipas Komisionit duhet ta shiste 1.134.900 lekë (48,5 m² x 23.400 lekë/ m²). Subjekti sqaroi se në vitin 1999 shiti apartamentin me sipërfaqe 48,5 m², në fshatin {***}, me distancë 0.8 kilometra larg qytetit të Shkodrës, për çmimin 200.000 lekë, për të blerë në po të njëjtën vlerë një apartament me sipërfaqe më të madhe, ndërsa shtesa prej 22,9 m² nuk ishte e përfunduar dhe nuk ishte e banueshme. Subjekti shpjegoi se, nëse i referohemi praktikës së regjistrimit të pasurisë, shitësit S. dhe M. D. e kanë blerë apartamentin nga Enti Kombëtar i Banesave në të njëjtën ditë që ia shitën atij (datë 23.08.1999), në shumën 41.600 lekë. Në përfundim të prapësimeve mbi rezultatet e hetimit për këtë pasuri, subjekti kërkoi që vlera e blerjes së apartamentit me sipërfaqe 73 m² duhet të konsiderohet në shumën 200.000 lekë, si dhe pretendoi që t'i përfshihet si e ardhur në analizën financiare shuma prej 200.000 lekësh e përfituar nga shitja e apartamentit në {***}.

12.11 Me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision kontratën⁸ e shitjes së apartamentit në {***}, duke pretenduar se me të ardhurat e krijuara nga kjo shitje ka blerë apartamentin objekt kontrolli. Kjo kontratë, sipas subjektit, është lidhur në vitin 2005, për arsye se blerësit nuk ndodheshin në Shqipëri, por subjekti pretendon se likuidimi i saj është kryer në vitin 1999 në momentin kur ka blerë apartamentin në Shkodër. Sipas kontratës së shitblerjes, subjekti i rivlerësimit shet apartamentin 1+1, me sip. 48,5 m², për çmimin 200.000 lekë, në fshatin {***}, Shkodër. Në nenin 4 të saj është shënuar se palët kanë likuiduar gjithë çmimin jashtë zyrës noteriale, duke mos përcaktuar, nëse pala blerëse ka likuiduar shitësin më herët, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, apo në momentin e lidhjes së kontratës. Subjekti dorëzoi në Komision një deklaratë noteriale⁹ të një prej blerësve të apartamentit në {***}, Gj. B., e cila ka deklaruar se në datën 20.08.1999, së bashku me vëllain e saj, N. B., ka blerë apartamentin e subjektit të rivlerësimit. Pavarësisht se në këtë datë nuk është nënshkruar kontrata e shitjes, deklaruesja ka sqaruar se kanë likuiduar menjëherë çmimin e shitjes së apartamentit prej 200.000 lekësh, pasi shitësi Lazer Çardaku donte të blinte shtëpi në Shkodër. Kjo zvarritje, shpjegon deklaruesja, është shkaktuar për shkak se blerësi tjetër, vëllai i saj (N. B.) nuk gjendej në Shqipëri, ndaj në momentin e kthimit të tij është hartuar kontrata e shitblerjes në vitin 2005.

12.12 Lidhur me momentin e shitjes së apartamentit në {***}, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit pretendon se shumën prej 200.000 lekësh, për shitjen e këtij apartamenti, e ka përfituar në vitin 1999, pikërisht kur donte të blinte apartamentin në Shkodër. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka dorëzuar deklaratën noteriale të datës 09.08.2024 të cituar në paragrafin më sipër, si dhe kontratën e shitblerjes së viti 2005. Lidhur me deklaratën noteriale të hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, Kolegji ka mbajtur qëndrime se ka vlerë provuese të kufizuar, për shkak se është hartuar pikërisht për të mbështetur pretendimet e subjektit të rivlerësimit gjatë këtij procesi. Edhe po të analizojmë në drejtim të pretendimit të subjektit se likuidimi i kësaj pasurie nga blerësi është kryer në vitin 1999, sërish duket se nuk ka logjikë ekonomike dhe tregtare që një apartament me sip. 48,5 m² në fshat të shitet në të njëjtin vit (1999) aq sa një apartament me sip. 73 m² në qytetin e Shkodrës. Për këtë arsye, si dhe të vetë ekzistencës së

⁸ Kontratë shitje nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.11.2005.

⁹ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 09.08.2024.

kontratës së shitblerjes së vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë se apartamenti në {***}, për të cilin është lidhur kontrata e shitblerjes në vitin 2005, të jetë likuiduar nga blerësi në vitin 1999, si rrjedhojë trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat e gjeneruara nga shitja e këtij apartamenti, për efekte të analizës financiare të subjektit të rivlerësimit, do të konsiderohen si të përfituara në vitin 2005, sipas përcaktimeve të kontratës së shitblerjes së tij.

12.13 Në vijim të sa më sipër, lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 73 m², në Shkodër, trupi gjykues vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka blerë apartamentin objekt kontrolli në vitin 1999, me çmimin 200.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes se kësaj pasurie. Në deklaratën e parë të pasurisë në vitin 2003, subjekti e ka deklaruar këtë apartament me vlerë 2.400.000 lekë, por nuk ka deklaruar shtesën anësore të apartamentit me sip. 22,9 m². Gjatë hetimit administrativ sqaroi se kjo shumë përfaqëson vlerën e tregut të këtyre pasurive dhe jo çmimin e blerjes. Në DIPP-në e vitit 2004 e ka deklaruar sërish apartamentin dhe jo shtesën, por me vlerë 2.000.000 lekë. Lidhur me këtë vlerë të ndryshme nga ajo e deklaruar në vitin 2003, subjekti sqaroi se në të nuk përfshihet vlera e shtesës anësore, pasi ishin orientuar të mos deklaronin pasuritë e paregjistruara. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si çmim të blerjes së apartamentit shumën 200.000 lekë, sipas kontratës së shitblerjes, ndërsa në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 15.01.2016 (përgjigje e pyetjes nr. 2), vlera e apartamentit bashkë me shtesën deklarohet sërish 2.400.000 lekë, pra, në një kohë të afërt me plotësimin e deklaratës *vetting*, në përmbajtje të së cilës çmimi i blerjes së apartamentit është deklaruar në shumën 200.000 lekë. Gjithashtu, në deklarimin në formë elektronike të vitit 2021 të kryer në ILDKPKI, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar këtë pasuri sërish me vlerë 2.400.000 lekë.

Nga rrethanat e cituara më sipër, rezultoi se në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar këtë pasuri me çmimin e përcaktuar në kontratën e shitjes së vitit 1999, në shumën 200.000 lekë. Trupi gjykues sjell në vëmendje jurisprudencën¹⁰ e Kolegjit, sipas së cilës pavarësisht se elementet e kontratës së shitjes në tregun e lirë, si të drejtat dhe detyrimet, imponohen nga vullneti i palëve kontraktore në përcaktimin e tyre, ky vullnet nuk është i pakufizuar në përcaktimin e çmimit dysHEME, i cili, për shkak të politikave fiskale, parashikohet në akte nënligjore, si, në udhëzimet dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e vlerës mesatare të shitjes së banesave në tregun e lirë. Në vijim të këtij arsytimi, çmimi i kontratës së shitblerjes, edhe pse i vendosur me vullnetin e dy palëve kontraktore, duket se nuk përfaqëson një vlerë reale të shitblerjes së apartamentit, kjo referuar situatave të analizuara më sipër dhe pretendimeve të subjektit.

12.14 Në vijim të arsytimit më sipër, trupi gjykues vëren se shitësit S. dhe M. D. e kanë blerë apartamentin nga Enti Kombëtar i Banesave për çmimin 41.600 lekë, në të njëjtën ditë që ia shitën subjektit (datë 23.08.1999), sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 23.08.1999, për çmimin 200.000 lekë. Në këtë kontratë nuk përcaktohet se me çfarë statusi e kanë përfituar këtë pasuri blerësit e parë, por duke u nisur nga prezenca e EKB-së në kontratën e shitblerjes, në cilësinë e palës shitëse, duket se blerësit mund të ishin pjesë e politikave sociale të EKB-së, për sistemimin me strehim të qytetarëve të pastrehë, ndaj çmimi, që i është mundësuar nga EKB-ja dhe i përcaktuar në kontratë shitësve S. dhe M. D., nuk përfaqëson vlerën reale të apartamentit, për pasojë nuk mund të merret në konsideratë si çmimi i kohës në tregun e lirë të banesave të asaj zone në Shkodër.

¹⁰ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 13 (JR), datë 04.04.2023, për subjektin e rivlerësimit Sh. M..

12.15 Trupi gjykues sjell në vëmendje se deklarata e interesave privatë/periodikë vjetorë për subjektet në funksion, e vitit 2021 (në format elektronik), është e ngjashme me deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim e vitit 2003 (depozituar në ILDKPKI në datën 19.03.2004), pasi kërkon prej subjekteve deklaruese deklarimin e të gjitha pasurive gjendje deri në datën 31.12.2021 dhe jo shtesat/pakësimet nga viti paraardhës deklarues. Ky deklarim i bërë në deklaratën e vitit 2021, i vlerësuar në raport me deklarimin e bërë nga subjekti në deklaratën fillestare të pasurisë dhe me shpjegimet e dhëna nga subjekti në ILDKPKI nëpërmjet procesverbalit “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë”, datë 15.01.2016, tregon koherencë nga ana e subjektit në deklarimin e vlerës së pasurisë objekt shqyrtimi.

Në këto kushte, ndonëse ka deklaruar në deklaratën *vetting* çmimin e blerjes së këtij apartamenti, sipas kontratës së shitblerjes, në shumën 200.000 lekë, në deklarimet periodike të viteve 2003 dhe 2004, procesverbalin në ILDKPKI në vitin 2016, si dhe deklarimin elektronik të vitit 2021, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një çmim të ndryshëm prej atij të përcaktuar në kontratë, duke pasur parasysh vlerën e kësaj pasurie. Dokumenti provues i vetëm për çmimin e blerjes së apartamentit është kontrata e shitblerjes së vitit 1999, në të cilën çmimi është përcaktuar në shumën 200.000 lekë, të cilën subjekti e ka dorëzuar bashkë me deklaratën *vetting*. Nga hetimi administrativ nuk rezultoi ndonjë dokument tjetër si mandatpagesë apo transfertë bankare që të dokumentojë një çmim të ndryshëm nga ai i parashikuar në kontratën e shitjes, përveçse vetëdeklarimeve të subjektit të përshkruara më lart. Për pasojë, në mungesë të provueshmërisë me dokumentacion ligjor, të çmimit real të blerjes së kësaj pasurie nga pala shitëse, bashkëshortët D., dhe në kushtet e pasjes në konsideratë se vlera prej 200.000 lekësh e përcaktuar si çmim shitje i kësaj pasurie në kontratën e shitjes, duket pak e besueshme, edhe në këndvështrim të deklarimeve të vetë subjektit lidhur me vlerën e saj, trupi gjykues e gjeti të drejtë qëndrimin e Komisioni se si çmim i blerjes së kësaj pasurie do të konsiderohet vlera prej 2.400.000 lekësh. Trupi gjykues konkludoi të konsiderojë këtë vlerë si çmim të paguar për blerjen e apartamentit, ndonëse nga vlerësimi që i bëhet atij, sipas çmimeve të EKB-së në vitet 1999, rezulton një vlerë më e ulët se kjo, madje duke abstraguuar nga fakti që ndërtimi nuk i përket kësaj periudhe, por shumë vite më parë. Pavarësisht këtyre rrethanave, trupi gjykues iu referua në konkluzionin e mësipërm deklarimeve që vetë subjekti ka bërë ndër vite për këtë pasuri.

12.16 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se shpenzimet e jetesës duhen të llogariten në nivelin 30% - 40% të të ardhurave, pasi ekonomia familjare është mbështetur pjesërisht nga prodhimet bujqësore në fshat, trupi gjykues, në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, konstaton se Komisioni ka përllogaritur shpenzimet e jetesës për periudhën 1992 – 1999, në masën 66% të të ardhurave nga paga. Referuar praktikës së Kolegjit¹¹, kreu korrigjimin e shpenzimeve të jetesës për këtë periudhë, duke i përllogaritur ato në nivelin e 30% të të ardhurave. Nga ky korrigjim, rezulton se balanca negative për mundësinë financiare të subjektit për blerjen e apartamentit objekt shqyrtimi reduktohet në (-)1.303.360 lekë, krahasuar me vlerën prej (-)1.867.346 lekësh të konstatuar nga Komisioni.

12.17 Komisioni, në vendim, ka konkluduar për deklarim të rremë të kryer në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *vetting*, lidhur me çmimin e blerjes së këtyre pasurive (apartament + shtesë), me dyshimin se çmimi i deklaruar nuk është real. Këtë konkluzion e ka kundërshtuar subjekti i rivlerësimit, i cili ka shpjeguar se prova e vetme që kishte për çmimin e blerjes së

¹¹ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 15/2019 (JR), datë 18.06.2019 dhe nr. 5/2022 (JR), datë 15.03.2022.*

kësaj pasurie ishte kontrata e shitblerjes së saj, çmim të cilin e ka pasqyruar në deklaratën *vetting*.

Kolegji sjell në vëmendje se në jurisprudencën¹² e tij, kontrolli i deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit dhe krahasimi i saj me deklaratimet e mëparshme u shërben Komisionit dhe Kolegjit për të ndjekur ecurinë dhe vërtetësinë e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pasurinë e deklaruar dhe për të nxjerrë konkluzionet mbi ligjshmërinë e pasurisë së subjektit të rivlerësimit apo mjaftueshmërinë e deklaratimeve të tij. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit.* Në interpretim të dispozitës të mësipërme, qëllimi dhe fryma e Kushtetutës dhe ligjit është e tillë që nga procesi i rivlerësimit të evidentohen të gjithë ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht apo plotësisht pasuritë e tyre. Ballafaqimi i deklaratimeve periodike me ato të bëra në deklaratën *vetting* u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë, si dhe nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe pasurisë së deklaruar.

12.18 Subjekti i rivlerësimit, në procesverbalin në ILDKPKI në vitin 2016, në afërsi kohore me deklaratën *vetting*, si dhe në deklarimin elektronik në vitin 2021, pas deklarimit *vetting*, ka deklaruar sërish vlerën e apartamentit në shumën 2.400.000 lekë, edhe pse e ka pasur në vëmendje çmimin e kontratës së deklaruar në deklaratën *vetting* në shumën 200.000 lekë. Kjo situatë vlerësohet se zhvesh subjektin e rivlerësimit nga qëllimi për të bërë deklarim të rremë për çmimin e blerjes së apartamentit, i cili do të duhej të shoqërohej edhe me veprime të tjera që e mbështesnin deklarimin në deklaratën *vetting*. Fakti që subjekti në disa deklarime pranë ILDKPKI-së deklaroi vlerë prej 2.400.000 lekësh, tregon se deklarimi i tij në deklaratën *vetting* është kryesisht i lidhur me aktin provues të çmimit, në këtë rast kontratën e shitjes, se sa me përpjekje të tij për të deklaruar në mënyrë të rreme atë. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerëson se nuk plotësohen kriteret e nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, për të kualifikuar situatën si një deklarim i rremë i parashikueshëm në nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e trupit gjykues, në konsideratë edhe të konkluzionit të arritur më sipër për vlerën e apartamentit, kjo situatë duhet të kualifikohet si një deklarim i pasaktë në deklaratën *vetting*, në të cilën subjekti kishte detyrimin të deklaronte qartësisht vlerën e apartamentit, mbështetur edhe në deklaratimet e tij të mëparshme dhe mëpashe.

12.19 Në përfundim të sa më sipër, lidhur me pasurinë “apartament banimi me sip. 73 m²”, ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë në deklaratën *vetting* për çmimin e blerjes së apartamentit në vitin 1999, duke u gjendur në këtë mënyrë para një deklarimi të pasaktë, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, si dhe nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, në Kolegji, ndaj analizës financiare të Komisionit, duke e korrigjuar atë në shpenzimet e jetesës, sipas jurisprudencës së Kolegjit, rezultoi mungesë e burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie në vlerën (-) 1.303.360 lekë, në kuptim të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 13.** *Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf 5”, me targë {***}, blerë nga djali i subjektit, B. Ç., në shumën 4.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka gabuar duke mos e njohur huanë e marrë nga djali i tij për blerjen e kësaj pasurie. Subjekti*

¹² *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 6/2018 (JR), paragrafi nr. 14; nr. 7/2018 (JR), paragrafët nr. 73, 74; nr. 8/2018 (JR), paragrafi nr. 43; nr. 9/2018(JR), paragrafi nr. 42; nr. 10/2018(JR), paragrafi nr. 67; nr. 12/2018(JR), paragrafi nr. 24.11; nr. 9/2019(JR), paragrafi nr. 10.1.1; nr. 19/2019(JR), paragrafi nr. 22.4.*

pretendon se ky qëndrim i Komisionit është i ndryshëm nga vendimmarrjet e tjera të Komisionit, në të cilat ka mbajtur qëndrim se huat e marra prej personave të tjerë dhe të shlyera brenda vitit nuk kanë pasur detyrim për t'i deklaruar. Subjekti pretendon se kjo marrëdhënie huaje nuk duhet të bëhet objekt analize, pasi përmes këtij veprimi juridik ka krijuar pasuri, të cilën gjithsesi do e krijonte brenda atij viti dhe të ardhurat nga shitja nuk kanë shërbyer si burim për blerjen e ndonjë pasurie tjetër në mënyrë që t'i analizohet burimi i ligjshëm. Subjekti pretendon se lidhja miqësore e fëmijëve të tij me pronarin e këtij mjete nuk i bën përdorues të tij në kuptimin juridiko-civil, por përdorues sporadikë, marrëdhënie e cila diferencon dukshëm nga ajo e përdorimit. Subjekti sqaron se duke qenë se familja e tij ka qenë me bilanc pozitiv në vitin 2013, nuk ka sens penalizimi për mospasje të burimeve financiare të ligjshme për një pasuri të tillë modeste, të cilën nuk e ka më dhe nuk i ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie tjetër. Gjithashtu, pasja e emrit në policën e sigurimit ka qenë një veprim rutinë i shpjeguar se përse ka ndodhur dhe nuk provon përdorimin konsistent të këtij mjete dhe, si rrjedhojë, detyrimin për t'u deklaruar si e tillë në deklaratën *vetting*. Në përfundim të këtij shkaku ankimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi i përdorimit sporadik i këtij mjete të moskonsiderohet si një shkelje dhe aq më pak si një shkak për shkarkimin e tij nga detyra.

13.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: *“Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. [...] Për sa më sipër, Komisioni çmon se në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting* (datë 26.01.2017), provohet nga aktet e administruara se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur kanë pasur në përdorim automjetin në fjalë, situatë kjo që e çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur janë në shkelje të detyrimit të deklarimit, sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim. Në përfundim të analizës, rezulton se në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit në fjalë subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës”.*

13.2 Në deklaratën *vetting*, djali i subjektit të rivlerësimit B. Ç. ka deklaruar si burim për blerjen e një automjeti tjetër (*Dymler Chrysler*), të ardhura nga shitja e mjeteve me targa {***}, në shumën 4.500 euro.

Në DIPP-në e vitit 2013, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit të markës “Volkswagen”, tip Golf, me targa {***}, me vlerë 4.000 euro, duke cilësuar si blerës djalin e tij B. Ç., por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

13.3 DPSHTRr-ja¹³ ka informuar Komisionin se djali i subjektit të rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë {***}. Në datën 14.03.2013, djali i subjektit të rivlerësimit e ka blerë¹⁴ këtë automjet nga shtetasi Gj. Ç. për çmimin prej 4.000 eurosh. Në datën 18.09.2015, djali i subjektit B. Ç. e ka shitur këtë automjet kundrejt çmimit 4.500 euro.

13.4 Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e AMF-së, Komisioni ka konstatuar se djali i subjektit, z. E. Ç., është shënuar si përdorues në policat e sigurimit të tipit *“Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”* të automjetit objekt kontrolli, edhe pas shitjes së këtij automjeti nga B. Ç. shtetasit A. K., për periudhat si vijon: (i) 19.09.2016 – 18.09.2017; (ii) 18.09.2017 – 17.09.2018; (iii)

¹³ Shkresë me nr. {***} prot., datë 05.02.2021.

¹⁴ Kontratë shitje e pasurisë së luajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.03.2013.

24.09.2018 – 23.09.2019; (iv) 01.10.2019 – 30.09.2020; (v) 01.10.2020 – 30.09.2021; dhe (vi) 12.10.2021 – 11.10.2022. Ndërsa, vetë subjekti i rivlerësimit figuron i shënuar si përdorurës në policat e sigurimit të këtij automjeti, sërish edhe pas shitjes së mjetit nga djali i tij, shtetasit A. K., për periudhat si vijon: (i) 19.09.2016 – 18.09.2017; dhe (ii) 18.09.2017 – 17.09.2018. Madje për këto periudha evidentohen policat të sigurimit të tipit “TPL”, ku nuk është shënuar fare emri i pronarit të këtij automjeti, A. K..

Përveç sa më sipër, nga të dhënat e përfituara nga sistemi *TIMS*, Komisionit i rezultoi se ky automjet është përdorur nga subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij (bashkëshortja dhe djemtë) në datën 08.01.2017, për një udhëtim jashtë vendit. Gjithashtu, konstatoi se ky automjet është përdorur nga familjarët e subjektit (bashkëshortja dhe djemtë) për disa udhëtime të tjera jashtë vendit, përkatësisht në datat: (i) 02.01.2017; (ii) 29.06.2017; (iii) 01.08.2017; (iv) 28-29.04.2019; dhe (v) 04.05.2019, kryesisht në Mal të Zi.

13.5 Lidhur me konstatimet e mësipërme, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurisë automjet “*Volkswagen Golf 5*” për një diferencë negative në shumën (-) 332.302 lekë. Gjithashtu, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi subjekti i rivlerësimit apo personat e lidhur nuk kanë deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *vetting*, në shkellje të detyrimit të përcaktuar në nenin D, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

13.6 Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit, lidhur me diferencën negative të rezultuar ka sqaruar se një pjesë e të ardhurave për blerjen e këtij automjeti në datën 14.03.2013 janë përballuar nga kursimet familjare, kurse pjesa tjetër është huazuar nga djali. Kështu, subjekti pretendon se djali i tij ka marrë një hua nga shtetasi P. P. (mik i familjes), në shumën 300.000 lekë, të cilën referon se e ka kthyer brenda vitit 2013. Pra, ky detyrim nuk ekzistonte në datën 31.12.2013 dhe, për këtë arsye, nuk është deklaruar nga djali. Në vijim të prapësimeve të tij, subjekti ka evidentuar faktin se në datën 28.10.2013, djali i tij B. Ç. ka shitur kundrejt vlerës 300.000 lekë automjetin me targë {***}, vlerë e cila është përfituar nga shitja e këtij automjeti dhe ka shërbyer për kthimin e huas shtetasit P. P., pasi nëse nuk do të ishin destinuar për shlyerjen e kësaj huaje do të ishin deklaruar si gjendje *cash*.

Lidhur me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit, subjekti ka sqaruar se ky përdorim nuk ka qenë i vazhdueshëm për të qenë objekt deklarimi dhe nëse i biri do ta dinte faktin se duhej ta deklaronte në deklaratën *vetting*, atëherë kjo do të ishte një rrethanë që do ta deklaronte pa asnjë hezitim. Sa i përket policave të sigurimit, përdorimi dhe emri i djalit ka qenë për faktin se ai me shtetasin A. K. janë miq të ngushtë dhe rrinë gjithmonë bashkë, duke evidentuar se këto policat janë plotësuar nga agjentët dhe kanë vazhduar tek e njëjta agjenci sigurimi, ku djali shkon gjithmonë për prerjen e siguracionit vjetor të këtij mjeti.

13.7 Në mbështetje të deklarimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën personale¹⁵ të shtetasit A. K., sipas së cilës ky i fundit ka deklaruar se është pronari i ligjshëm i automjetit objekt kontrolli, të cilin e disponon që nga viti 2015, dhe se për shkak të rrethanave të njohjes dhe miqësisë me djemtë e subjektit të rivlerësimit, ia ka lënë për ta përdorur djalit të subjektit E. Ç., në ndonjë rast, si dhe për udhëtime jashtë vendit. Gjithashtu, ky shtetas ka deklaruar se përdorimi ka qenë i shkurtër, një - dy ditë, dhe në të gjitha rastet ka qenë në dijeni të përdorimit të automjetit dhe lëvizjeve të kryera prej tij (djalit të subjektit). Në përfundim, ka deklaruar se nisur nga fakti se ka pasur njohje me agjentë të shoqërisë së sigurimeve {***}, ka

¹⁵ Vërtetim nënshkrimi i deklaratës, nr. {***} rep., datë 29.10.2024.

shkuar së bashku me E. për të përfituar ndonjë ulje në vlerën e siguracionit, për këtë arsye, emrat e tyre kanë mbetur në policën e sigurimit. Komisioni, në vendim, çmoi se nuk u administruan indicie/prova të mjaftueshme, të tilla që të bënin të mundur konstatimin fillestar në rezultate të hetimit, që i përket dyshimeve të ngritura për pasuri të fshehur të disponuar nga subjekti apo personat e lidhur me të.

13.8 Lidhur me situatën e mësipërme faktike të përdorimit të automjetit prej subjektit të rivlerësimit dhe prej djalit të tij edhe pas shitjes së këtij mjete, të konstatuar gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vlerëson se subjekti kishte detyrimin të deklaronte këtë marrëdhënie në zbatim të përcaktimeve të nenit 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën jepet përkufizimi i fjalës “pasuri”, duke u përcaktuar se: *“Pasuri janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit”*. Ky parashikim, i parë në harmoni me nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij*, detyronte subjektin e rivlerësimit të deklaronte përdorimin e këtij automjeti si një pasuri në përdorim të tij, përderisa nga polica e sigurimit me nr. serie {***}, lëshuar nga shoqëria {***}, ai rezultonte se kishte të drejta përdorimi mbi këtë automjet për periudhën e sigurimit 19.09.2016 – 18.09.2017, periudhë e cila përfshin brenda saj kohën e depozitimit të deklaratës së pasurisë *vetting* në datën 26.01.2017.

13.9 Në këtë kontekst, konkluzioni i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pasaktë është i drejtë, për arsye se subjekti duhej ta kishte deklaruar përdorimin e këtij mjete.

13.10 Lidhur me pretendimin e subjektit se marrëdhënia e huasë prej 300.000 lekësh e marrë nga huadhënësi z. P. P., që ka shërbyer si burim për blerjen e këtij mjete, nuk duhet të merret në analizë, pasi është shlyer brenda vitit 2013, Kolegji vëren se në DIPP-në e vitit 2013, ku është deklaruar blerja e automjetit, nuk është deklaruar burimi i krijimit të këtij automjeti. Subjekti i rivlerësimit pretendoi se kjo hua është shlyer dy muaj pasi është marrë nga huadhënësi, ndaj nuk kishte detyrimin për ta deklaruar. Komisioni nuk e ka përfshirë si të ardhur në analizën e subjektit të rivlerësimit shumë prej 300.000 lekësh të marrë hua nga z. P., gjithashtu nuk e ka përlllogaritur as si shpenzim në këtë analizë. Subjekti i rivlerësimit, me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, dorëzoi në Komision deklaratën personale¹⁶ të z. P. P., i cili ka deklaruar se kanë miqësi me familjen e subjektit të rivlerësimit. Gjithashtu, ka sqaruar se merret me biznes privat prej vitesh dhe është tatimpagues i rregullt. Ai ka deklaruar se më 14.03.2013 djali i subjektit të rivlerësimit, z. B. Ç., i ka treguar se donte të blinte një automjet dhe se i mungonin 300.000 lekë, ndaj nëse mundej t’ia jepte hua. Deklaruesi sqaron se ia ka dhënë shumë, të cilën djali i subjektit ia ka kthyer më 28.10.2013.

Duke qenë se kjo hua është marrë dhe shlyer brenda vitit 2013, duke konsideruar se shuma është relativisht e vogël, si dhe z. P. rezulton se ka aktivitet privat, trupi gjykues vlerësoi të konsiderojë të besueshme këtë marrëdhënie, për huanë e marrë nga ky person, që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi

¹⁶ Vërtetim nënshkrimi me nr. {***} rep., datë 28.10.2024.

13.11 Në vijim të sa më sipëranalizuar, lidhur me këtë pasuri, blerë në vitin 2013 nga djali i subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerësoi se subjekti ka pasaktësi në deklaratën *vetting*, për shkak të mosdeklarimit të përdorimit të këtij mjeti, të rezultuar nga policat e sigurimit, sipas leximit *a contrario* të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, duke njohur huanë e përkohshme prej 300.000 lekësh marrë nga djali i tij, rezultoi një balancë negative prej (-) 32.302 lekësh, e cila u vlerësua pa peshë përcaktuese për vlerësimin e kësaj pasurie.

14. *Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Lupo”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka gabuar që ka vlerësuar një pasuri që nuk e posedon më dhe që nuk ka shërbyer si burim për blerjen e një pasurie tjetër. Subjekti i rivlerësimit, në ankim, shpjegon se kjo është një pasuri modeste dhe shpenzimet jetike nuk mund të llogariten me shifra të prera matematikore, pasi askush nuk shpenzon njësoj çdo muaj. Subjekti sqaron se organet e rivlerësimit nuk kanë mbajtur qëndrime të prera për mosnjohjen e mbajtjes së kursimeve të viteve pararendëse dhe kjo ka më shumë kuptim për shuma të vogla të papërfillshme. Subjekti ka sqaruar se Kolegji ka mbajtur qëndrime elastike në drejtim të vlerësimit të harresave në deklarimin e kursimeve *cash* në deklaratat periodike, duke mos i konsideruar ato si shkak shkarkimi edhe kur kanë qenë shuma të konsiderueshme e jo më për vlera të papërfillshme siç është në rastin konkret që përkon me gjysmën e rrogës mujore.*

14.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: *“Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi për një diferencë negative në shumën (-) 64.113 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

14.2 Në DIPP-në e vitit 2015, në seksionin e deklarimit të pasurive, subjekti ka deklaruar blerjen e nga djali i tij B. Ç., të automjetit të markës “Volkswagen”, tip Lupo, me targa {***}, blerë me çmimin 1.000 euro, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

14.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se DPShTRr-ja ka dërguar në Komision informacionin¹⁷ se djali i subjektit të rivlerësimit ka pasur të regjistruar automjetin me targë {***}. Nga verifikimi i kryer nga Komisioni ka rezultuar se në datën 10.03.2015, djali i subjektit B. Ç. e ka blerë¹⁸ këtë automjet për çmimin prej 1.000 eurosh dhe në datën 01.07.2015, e ka shitur¹⁹ këtë automjet kundrejt çmimit prej 150.000 lekësh.

Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, Komisioni kreu analizën e treguesve financiare me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur për kryerjen deri në datën 10.03.2015, të pagesës për blerjen e automjetit të markës “Volkswagen”, nga e cila ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e pasurisë objekt vlerësimi për një diferencë negative në shumën (-) 64.113 lekë.

14.4 Lidhur me konstatimin e mësipërm, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e asaj çfarë ka rezultuar, në përgjigje të së cilës subjekti papësoi se megjithëse nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit 2014, gjithsesi ai ka pasur në gjendje kursime, të cilat, së bashku me të ardhurat e realizuara për

¹⁷ Shkresë me nr. {***} prot., datë 05.02.2021, e DPShTRr-së.

¹⁸ Kontratë shitje e pasurisë së luajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.03.2015.

¹⁹ Kontratë shitblerje pasuri të luajtshme me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.07.2015.

periudhën janar – mars të vitit 2015, kanë mundësuar blerjen e automjetit në datën 10.03.2015 nga djali i tij, në shumën 1.000 euro. Subjekti sqaron se në deklaratimet periodike vjetore 2003-2014 nuk ka deklaruar shtesë kursimesh në vlera materiale që do të ishin objekt deklarimi. Gjithashtu, shpjegoi se në fund të çdo viti ka pasur vlera monetare në banesë për të mbuluar balancën negative në shumën prej (-) 64.113 lekësh.

14.5 Sa më sipër rezultuar, trupi gjykues vëren se nga gjithë dokumentacioni i administruar në dosje dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, për automjetin e blerë nga djali i tij, rezultoi se nuk është deklaruar burimi i krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike të vitit 2013. Subjekti i rivlerësimit rezultoi në Komision me diferencë negative për blerjen e kësaj pasurie, të cilën subjekti e justifikon se ka pasur likuiditet *cash* në banesë për të mbuluar diferencën negative, pavarësisht se nuk e ka deklaruar. Trupi gjykues vlerëson se, bazuar në nenin 4, germa “d” e ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në ILDKPKI vlerën e likuiditeteve, gjendjen *cash*, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Sipas kësaj dispozite, pavarësisht se shuma e diferencës negative është relativisht e vogël, subjekti i rivlerësimit duhej të deklaronte vit pas viti gjendjen e likuiditeteve, për të mundësuar në këtë mënyrë kontrollin e pasurisë së tij nëpërmjet procesit të rivlerësimit. Ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit të pasurisë përcaktojnë detyrimin e subjektit deklarues të deklarojë në formën e përcaktuar prej tyre dhe jo të zgjedhë mënyra të personalizuar për të kryer këtë detyrim ligjor. Forma e deklarimit nuk është trajtuar prej ligjit si një detyrim alternativ, i cili mbetet në vullnetin e subjektit, por një detyrim i mirëpërcaktuar, i cili duhet respektuar.

14.6 Në përfundim të analizës më sipër, lidhur me automjetin objekt shqyrtimi, blerë në vitin 2015 nga djali i subjektit të rivlerësimit, nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, pavarësisht se konfirmoi mungesën e burimeve të ligjshme prej (-) 64.113 lekësh të rezultuar në Komision, e konsideroi atë pa peshë përcaktuese për vlerësimin kriterit të pasurisë.

15. *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 48,5 m², ndodhur në {***}, Shkodër, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se Komisioni ka gabuar që nuk ka konsideruar në vitin 1999 përfitimin e të ardhurave nga shitja e këtij apartamenti, duke mosrespektuar parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit. Subjekti argumenton se sa i përket mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën fillestare të vitit 2003, si dhe atë periodike të vitit 2005, megjithëse e pranon se formalisht ka qenë një e metë për shkak të mospasjes së qartë të mënyrës së deklarimit të pasurive, një fakt i tillë nuk duhet të afektojë procesin e tij të rivlerësimit, pasi objekt i kontrollit të tyre nuk janë deklaratat periodike, por deklarata *vetting*, në të cilën sqaron se e ka deklaruar rregullisht, përfshirë shitjen e saj. Subjekti pretendon se kjo pasuri nuk duhej të analizohet pasi është blerë 30 vite më parë dhe në një kohë kur subjekti nuk kishte filluar akoma të ushtronte detyrën (5 vite më herët). Subjekti sqaron se koha e krijimit të pasurisë është mbajtur në konsideratë në shumë vendime të Kolegjit, si dhe nga GjEDNj-ja në çështjen *Sevdari kundër Shqipërisë*.*

Lidhur me pamundësinë financiare për blerjen e këtij apartamenti të konstatuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit pretendon se është një analizë e metë, pasi për blerjen e kësaj pasurie duhet të konsiderohet pagesa e kështit të parë në shumën 50.000 lekë në vitin 1994, duke sqaruar se është përgjigjur edhe në pyetësorin nr. 2 se likuidimi i shumës për blerjen e banesës është kryer me këste gjatë viteve 1995, 1996 dhe 1997. Subjekti pretendon se shpenzimet e

përlllogaritura nga Komisioni në masën 66% e të ardhurave vjetore nuk janë të sakta, pasi ka përlllogaritur një nivel shpenzimesh më të lartë dhe nga ana tjetër nuk ka njohur produktet bujqësore të prodhuara në fshat. Subjekti sqaron se shpenzimet jetike për këtë periudhë duhet të jenë më të ulëta, në nivelin 30-40%, të konsiderohet kësti i parë prej 50.000 lekësh i paguar në vitin 1994 dhe këstet e tjera të shpërndahen deri në vitin 1997, si dhe të konsiderohen kursimet nga viti 1982-1992 në masën 40.000 lekë.

15.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: *“Bazuar në deklaratimet e bëra dhe dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në vlerësim objektiv të shpjegimeve dhe provave të depozituara pas rezultateve të hetimit, Komisioni kreu analizën përfundimtare të treguesve financiarë me qëllim evidentimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për kryerjen deri në datën 08.12.1994 të pagesës për blerjen e apartamentit të banimit në {***}, Shkodër, nga e cila rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, për diferencën negative në shumën -127.604 lekë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016”.*

15.2 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit apartament banimi 1+1, me sipërfaqe prej 48,5 m², ndodhur në fshatin {***}, Shkodër, për të cilin referon se e ka fituar me privatizim dhe shitur në vitin 2005, për shumën prej 200.000 lekësh.

15.3 Referuar dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se apartamenti është përfituar nga subjekti nëpërmjet kontratës²⁰ së shitblerjes së datës 08.12.1994, me palë shitëse shtetasit Gj. dhe Sh. B.. Komisioni konstatoi se kjo pasuri nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie të vitit 2003, dhe se po ashtu nuk është deklaruar shitja/pakësimi i saj në DIPP-në e vitit 2005. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie në deklaratën e vitit 2003, për mosdeklarimin e shitjes së saj në DIPP-në e vitit 2005, si dhe mbi deklarimin e bërë se kjo pasuri është përfituar nëpërmjet privatizimit, ndërkohë që duket se ajo është përfituar nga shitës individë dhe jo shteti. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me mosdeklarimin e pasurisë në deklaratën e vitit 2003, sqaroi se pas largimit nga vendlindja {***}, ish-Komuna Shalë, më datë 08.12.1994, ka blerë një apartament banimi me sipërfaqe 48,5 m², të ndodhur në {***}, Shkodër, për çmimin prej 200.000 lekësh, duke pretenduar se çmimi i dakordësuar është paguar i shtrirë në kohë përgjatë viteve 1994 – 1997, pavarësisht se në kontratën e shitblerjes ka qenë e përcaktuar se likuidimi i kësaj shume është bërë menjëherë. Lidhur me mosdeklarimin e shitjes në DIPP-në e vitit 2005, subjekti shpjegoi se me transferimin e tij nga Prokuroria e Rrethit Pukë në Prokurorinë e Rrethit Shkodër, për shkak të distancës, vazhdimin të shkollës nga fëmijët etj., është detyruar të gjejë banesë në qytetin e Shkodrës dhe të shesë apartamentin e banimit në fshatin {***}. Subjekti sqaroi se më datë 20.08.1999, këtë apartament ia ka shitur shtetasve Gj. B. dhe vëllait të saj, N. B., për shumën prej 200.000 lekësh. Në këtë datë, pavarësisht se nuk kanë bërë dhe nënshkruar aktin e shitblerjes, nga ana e blerësve është likuiduar shuma prej 200.000 lekësh, pasi ato ditë do të blinte apartamentin në Shkodër. Një veprim i tillë është kryer në mirëbesim mes dy palëve, pasi ishin banorë të pallateve në fshatin {***}, që vinin nga e njëjta zonë me njohje të gjatë familjare. Sipas sqarimeve të subjektit, akti i shitblerjes së kësaj pasurie është bërë me vonesë, pasi njëri nga blerësit, N. B., është larguar

²⁰ Kontratë shitblerje me nr. {***} rep., dhe nr. kol. i palexueshëm, datë 08.12.1994.

jashtë vendit, duke qëndruar disa vite pa ardhur në Shqipëri. Me kthimin e tij në Shqipëri, kanë nënshkruar aktin përfundimtar të shitblerjes së kësaj pasurie më datë 10.11.2005.

15.4 Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, deklaratën noteriale²¹ të blerëses Gj. B., sipas së cilës ka deklaruar se apartamenti është blerë në datën 20.08.1999 dhe pagesa për blerjen e tij është dhënë po atë ditë, pavarësisht se kontrata është lidhur në vitin 2005, për shkak të qëndrimit të vëllait të saj jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, dorëzoi edhe deklaratën noteriale²² të shitëses së këtij apartamenti, Sh. B., e cila deklaroi se apartamentin e ka blerë në vitin 1994 për shumën 200.000 lekë, për likuidimin e të cilit deklaroi se është rënë dakord me subjektin e rivlerësimit që të shlyhet në vitet 1995, 1996 dhe 1997. Për këtë qëllim, sqaroi se kanë mbajtur një deklaratë dore të nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, por nuk e disponojnë më, pasi nuk kanë pasur interes për ta ruajtur. Këto deklarata noteriale janë dorëzuar gjatë hetimit administrativ në Komision, ndaj ashtu si më sipër referuar qëndrimeve të Kolegjit, fuqia e tyre provuese në këtë proces nuk është domethënëse, pasi është kryer gjatë dhe për shkak të procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit.

15.5 Sa më sipëranalizuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shitur apartamentin në fshatin {***}, në vitin 2005, sipas kontratës së shitjes së datës 10.11.2005. Subjekti pretendoi se shuma prej 200.000 lekësh e përfitur nga shitja e apartamentit nuk është marrë nga blerësit në vitin 2005, por në vitin 1999, pikërisht se atëherë i nevojitej të blinte apartamentin tjetër në Shkodër. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbeti në nivel deklarativ dhe ai nuk arriti të provojë me dokumente që kjo shumë është marrë në vitin 1999, përveç deklaratës noteriale të blerëses, e cila është konceptuar në vitin 2024, pikërisht në kohën kur subjekti po kryente procesin e rivlerësimit, ndaj deklaratimet e saj mund të kenë pasur qëllim mbështetjen dhe suportin e situatës së subjektit të rivlerësimit.

15.6 Trupit gjykues i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri as në vitin 2003 dhe as në vitin 2005 kur e ka pakësuar. Në deklaratën *vetting* ka dorëzuar kontratën e shitblerjes së vitit 2005. Gjithashtu, subjekti pretendoi, në ankim, se blerja prej tij e kësaj pasurie është kryer me këste në vitin 1994 paguar shuma 50.000 lekë dhe pjesa tjetër në vitet 1995, 1996 dhe 1997. Për këtë pretendim nuk dorëzoi dokumentacion provues, përveç kontratës së blerjes së apartamentit më datë 08.12.1994. Dokumenti i vetëm që tregon se kur është pakësuar kjo pasuri është kontrata e shitjes së vitit 2005, ndaj pavarësisht se subjekti pretendoi se çmimi është likuiduar nga blerësit në vitin 1999, pretendim i cili nuk u provua me dokumentacion ligjor, trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare përfundimtare të subjektit të rivlerësimit të konsiderohet se pagesa për blerjen e kësaj pasurie në shumën 200.000 lekë të jetë kryer nga subjekti në datën 08.12.1994, dhe se të ardhurat e përfituara nga shitja e saj do të reflektohen në vitin 2005, ashtu si është konkluduar në paragrafin 15.16 më sipër në këtë vendim. Shpenzimet e jetesës për periudhën e analizuar, gjithashtu, u konsideruan në masën 30% të të ardhurave nga punësimi, sikundër analizuar më lart.

15.7 Në përfundim të analizës së këtij shkakut ankimi, lidhur me pasurinë “apartament banimi” ndodhur në {***}, Shkodër, blerë nga subjekti i rivlerësimit në vitin 1994, nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, duke korrigjuar shpenzimet e jetesës,

²¹ Deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.08.20224.

²² Deklaratë noteriale me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.08.20224.

sipas jurisprudencës së Kolegjit, subjekti rezultoi me diferencë negative në shumën (-) 57.338 lekë për blerjen e tij, e cila u vlerësua pa peshë përcaktuese për vlerësimin kriterit të pasurisë.

16. *Lidhur me automjetin tip “Opel Moka”, me targë {***}, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se Komisioni ka dalë jashtë funksionit të tij në hetimin, analizimin dhe përfundimet në lidhje me këtë pasuri, pasi ajo nuk i nënshtrohet procesit të rivlerësimit kalimtar. Subjekti pretendon se nuk e ka fshehur përdorimin e këtij mjete, por sipas legjislacionit në fuqi dhe praktikave ligjore nuk e ka pasur një detyrim të tillë ligjor deklarimin e përdorimit të këtij mjete në DIPP-në e vitit 2023. Subjekti, gjithashtu, pretendon se është krejtësisht i pabazuar dhe abuziv përfundimi i Komisionit për cenim të figurës së prokurorit, duke pasjellë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë pa analizuar se cilat janë veprimet e tij që përbëjnë këtë cenim të besimit të publikut. Sipas subjektit, ky lloj shkak, për shkarkimin nga detyra, merret në ato raste kur kryhet vlerësim tërësor i tri kriterëve të vlerësimit, ndërkohë që subjekti është vlerësuar se ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, ndaj në rastin në shqyrtim nuk mund të merret një vendim shkarkimi për cenim besimi të publikut në sistemin e drejtësisë vetëm duke iu referuar kriterit të vlerësimit të pasurisë.*

16.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: “[...] Rrethana të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën cenojnë figurën e prokurorit të Republikës së Shqipërisë, duke pasjellë cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të bërë në nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016. Megjithëse kemi të bëjmë me pasuri të përdorur pas dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar vetting, në analizë të të gjitha prapësimeve të bëra nga subjekti mbi këtë pasuri – Komisioni vlerëson se nuk qëndron pretendimi i tij se nuk ka pasur detyrim deklarimin e përdorimit të këtij automjeti në deklaratën e interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2023. Kështu, Komisioni sjell në vëmendje se me ligjin nr. 42/2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, në shkronjën “b” të nenit 4 të ligjit ekzistues, që referon deklarimin e pasurive të luajtshme, pas fjalëve “në regjistrat publikë”, shtohen fjalët “dhe të drejtat reale mbi to”, sipas Kodit Civil”.

16.2 Komisioni ka kryer verifikime në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Financiare, nga të cilat ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit është shënuar si “përdorues” në policat e sigurimit të automjetit të markës “Opel”, tip Mokka, me targa {***}, vit prodhimi 2018, me pronar shtetasin K. T., polica të cilat i përkasin periudhave: (i) 24.04.2023 – 23.04.2024; dhe (ii) 23.04.2024 – 22.04.2025. Komisioni, gjithashtu, ka konstatuar nga të dhënat e sistemit TIMS se ky automjet është përdorur në datën 29.04.2023, nga subjekti i rivlerësimit dhe djali i tij, B. Ç., për një udhëtim jashtë vendit. Gjithashtu, nga verifikimi i të dhënave prej sistemit TIMS për shtetasin K. T., Komisionit i ka rezultuar se ka pasur hyrje-dalje të shpeshta jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me automjete të ndryshme, por asnjëherë me automjetin e tij të markës “Opel”, tipi Mokka me targa {***}.

16.3 Lidhur me sa më sipër konstatuar, Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme për pasuri të fshehur të subjektit, të disponuar prej tij dhe/apo djalit të tij B. Ç., të regjistruar në emër të shtetasit K. T., duke i kërkuar: (i) të japë detaje mbi përdorimin e këtij automjeti – lidhjen e subjektit dhe personit të lidhur me të; (ii) kush ka qenë pronari i këtij automjeti në periudhën gjatë së cilës subjekti e ka përdorur apo ka udhëtuar me të, si edhe nga kush e ka marrë në përdorim këtë automjet; (iii) të deklarojë mbi marrëdhënien e tij me këtë/a shtetas, duke

konfirmuar, gjithashtu, nëse e ka pasur në ndjekje, hetim, gjykim material, çështje ku si palë mund të ketë qenë pronari i këtij automjeti.

16.4 Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se ka pasur si qëllim blerjen e këtij automjeti dhe e ka marrë në përdorim prej mesit të muajit mars 2023. Subjekti sqaroi se pas dakordësisë për çmimin dhe kryerjen e dorëzimit të automjetit, për shkak se z. T. nuk është paraqitur për ta finalizuar këtë marrëdhënie, e më tej është larguar nga Shqipëria në fund të muajit korrik 2023, nuk ka mundur ta nënshkruajë kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie. Në shpjegimet e tij, subjekti ka sqaruar se nuk e ka njohur më parë këtë individ dhe se kontakti i parë me të ka qenë në momentin që janë takuar për të diskutuar blerjen e këtij automjeti. Në vijim, subjekti deklaroi se prej muajit korrik të vitit 2023 e deri në 30 prill të vitit 2024, z. T. ka qenë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, rrethanë për të cilën referon se ka pamundësuar nënshkrimin e kontratës gjatë kësaj periudhe. Në përfundim të shpjegimeve të tij, parashtron se me ardhjen e këtij shtetasi në Shqipëri në datën 02.05.2024, janë paraqitur pranë sporteleve të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor për të realizuar kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie, por aty është vënë në dijeni se mjeti rezultoi me shënimin “Interpol Pozitiv”²³. Në këto rrethana, deklaroi se ia ka dorëzuar automjetin shtetasit K. T., duke mos e finalizuar këtë marrëdhënie dhe duke e orientuar këtë shtetas ta dorëzojë automjetin pranë Drejtorisë së Policisë Shkodër.

16.5 Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë shkresën e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Shkodër me nr. {***} prot., datë 23.10.2024, sipas së cilës, referohet se, për sa i përket automjetit tip “Opel Mokka”, me targë {***}, pas verifikimeve në dosjen bazë të këtij mjeti rezultoi se në datën 02.05.2024 janë paraqitur në sportelet e kësaj drejtorie për të realizuar kontratën e shitblerjes së mjetit shtetasit K. T. (në cilësinë e shitësit) dhe Lazer Çardaku (në cilësinë e blerësit), por pas dorëzimit të kartave të identitetit dhe verifikimeve në sistem, ky mjet rezultoi me “Interpol Pozitiv”, duke sjellë si rrjedhojë ndërprerjen e procedurës së mëtejshme për lidhjen e kontratës së shitblerjes.

16.6 Pasi vlerësoi provat e administruara gjatë hetimit administrativ, si dhe shpjegimet dhe provat e depozituara me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, në kushtet kur edhe vetë subjekti pranoi përdorimin e këtij automjeti dhe qëllimin për blerjen e tij, Komisioni vlerësoi se nuk mund të qëndrojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm konstatimi për pasuri të fshehur të subjektit, duke konkluduar se këto rrethana të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën cenojnë figurën e prokurorit të Republikës së Shqipërisë, duke pasqyruar cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas parashikimit të bërë në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

16.7 Në analizë të dokumentacionit të administruar në dosje, si dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, trupit gjykues i rezultoi se subjekti në vitin 2023 ka përdorur automjetin për periudhën 24.04.2023-22.04.2025, sipas policave të sigurimit, ku figuron përdorues i mjetit, përdorim të cilin ai e justifikoi me mungesën e prezencës në Shqipëri të pronarit të mjetit, si shkak që ka ndikuar në pamundësinë për të lidhur kontratën e shitblerjes.

16.8 Pavarësisht rrethanave të rezultuara lidhur me përdorimin e këtij mjeti, problematikat e konstatuara në lidhje me përdorimin në vitin 2023-2024 nga subjekti i rivlerësimit të një mjeti që i përkiste një personi që nuk e njihete, pas plotësimit të deklaratës *vetting*, për një pasuri të cilën subjekti nuk e ka paguar, por e ka përdorur, siç ka rezultuar në policat e sigurimit, referuar

²³ Në shkresë nuk sqarohet kuptimi i këtij togfjalëshi, por duket si mjet që është raportuar nga Interpol.

jurisprudencës së Kolegjit²⁴, rezulton se analizimi i kësaj pasurie mbetet përtej periudhës për të cilën ushtrohet kontroll nga institucionet e rivlerësimit. Problematika të tilla do të duhet t'i nënshtrohen, si rregull, kontrollit të institucioneve të tjera të specializuara shtetërore, të cilat kryejnë kontroll periodik.

16.9 Në përfundim të analizës më sipër, lidhur me përdorimin e automjetit objekt kontrolli, të rezultuar nga policat e sigurimit në periudhën 2023-2025, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se përveçse përdorimi në këto vite mbetet jashtë periudhës së rivlerësimit, gjithashtu nuk konstatoi asnjë sjellje të subjektit që mund të konsiderohej me peshë në kontekstin e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

16.10 *Së fundmi*, në kushtet kur nuk rezultojnë dyshime të cilat do të mund të analizoheshin në drejtim të fshehjes së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe as sjellje të subjektit që do mund të afektonin besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, ky konkluzion i Komisionit mbetet jashtë vlerësimit të kriterit të pasurisë në Kolegj.

17. *Lidhur me denoncimin për pasuri të fshehur në Velipojë, Shkodër*, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se mënyra e zhvillimit të hetimit nga Komisioni për këto denoncime anonime tregon për anshmërinë dhe paragjykimin e Komisionit me qëllim gjetjen me çdo kusht të një shkakut për ta shkarkuar nga detyra. Subjekti argumenton se përshtypja e Komisionit se e ka përdorur apartamentin në Velipojë pakundërshpërblim, nuk ka cilësinë provuese të kërkuar nga ligji nr. 84/2016, nenet 41 dhe 49-51 të tij. Subjekti sqaron se përdorimi rastësor i një pasurie për një afat të shkurtër është konsideruar si nëdorësi dhe jo si përdorim afatgjatë dhe i qëndrueshëm. Subjekti pretendon se ka ofruar bashkëpunim maksimal me Komisionin gjatë gjithë fazave të procesit, duke iu përgjigjur në kohë të gjitha pyetjeve të drejtuara, përfshirë ato mbi dyshimet e ngritura nga denoncimet anonime të mësipërme. Subjekti, në përfundim të këtij shkakut ankimi ka pretenduar, se këto denoncime janë haptazi të pambështetura në situatën faktike dhe kuadrin ligjor për rivlerësimin kalimtar.

17.1 Konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri: *“Pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet e dhëna nga subjekti me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit – mbi dyshimet e ngritura nga Komisioni për pasuri të paluajtshme të fshehur në raport me provat e administruara gjatë hetimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm disponimi prej subjektit i kësaj pasurie në zonën e Velipojës. [...] Komisioni vlerëson se në kundërshtim me parashikimet e bëra në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të hetimit – duke mos deklaruar përdorimin e kësaj pasurie dhe se kjo sjellje e tij do të mbahet parasys në vendimmarrje”.*

17.2 Pranë Komisionit janë administruar tre denoncime anonime²⁵, të cilat referojnë se subjekti i rivlerësimit disponon një apartament në zonën e plazhit të Velipojës, në objektin e ndërtuar nga ish-kryetari i komunës, i ndjeri P. U.. Dy prej denoncimeve shoqërohen me lista, emrat në përbërje të të cilave, pretendohet se i përkasin banorëve të këtij objekti. Në këto lista është evidentuar kryerja ose jo e pagesave të mirëmbajtjes së pallatit, ku ndër ta figuron i shënuar edhe emri i subjektit të rivlerësimit Lazer Çardaku. Gjithashtu, në njërin prej

²⁴ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 22/2022 (JR), datë 22.06.2022.

²⁵ (i) Denoncim anonim nr. {***} prot., datë 06.09.2023; (ii) denoncimi anonim nr. {***} prot., datë 17.11.2023; dhe (iii) denoncimi i depozituar pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM) nr. {***} prot., datë 04.06.2024.

denoncimeve jepen të dhëna konkrete mbi objektin, si shoqëria ndërtuese, nr. i pasurisë, zona kadastrale, si dhe foto të ekstraktuara nga platforma *google earth*.

17.3 Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit në pyetësorin standard, nëse gjatë të gjithë periudhës së deklarimit ka përdorur ndonjëherë prona të regjistruara në emër të dikujt tjetër (si makina, shtëpi, mjete lundrimi, apartamente, shtëpi verore etj.), në përgjigje të të cilit subjekti i rivlerësimit e ka mohuar përdorimin e pasurive të regjistruara në emër të dikujt tjetër. Komisioni ka kërkuar informacion²⁶ nga AShK-ja, Drejtoria Vendore Shkodër, për të gjitha pasuritë e regjistruara (apartamente, garazhe, njësi) dhe pronarët përkatës, lidhur me objektin e ndërtuar nga shoqëria sipërmarrëse “{***}” ShPK, i cili ndodhet në zonën e Velipojës, regjistruar me nr. pasurie {***}, në zonën kadastrale {***}.

AShK-ja Drejtoria Vendore Shkodër²⁷ informon se pasuria me nr. {***}, ndodhur në P., Velipojë, e llojit truall + ndërtesë me sipërfaqe 1601.8 m², nga të cilat 1,083 m² ndërtesë, në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK, është fituar me leje legalizimi nr. {***}, datë 23.07.2019. Komisioni thirri si dëshmitar përfaqësuesin ligjor, njëkohësisht dhe ortak i vetëm i shoqërisë më sipër, z. N. Ç., i cili u pyet nëse e njuh subjektin e rivlerësimit dhe nëse ka apartament në godinën që ka ndërtuar. Z. Ç. u përgjigj se subjekti i rivlerësimit ka qëndruar në atë godinë, të paktën atë vit që ka qëndruar edhe ai vetë, duke referuar vitin 2017, por nuk e di se te cili apartament dhe nëse e ka pasur në përdorim apo e ka marrë me qira. Ai referoi se i ndjeri P. U. ka disa apartamente që i ka kthyer në hotel dhe i administron gruaja e tij N. dhe vëllai i saj A. C..

Përveç sa më sipër, Komisioni njoftoi shtetasin A. C. për t’u paraqitur në cilësinë e dëshmitarit (kunati i P. U.), me qëllim marrjen e dëshmisë së tij mbi rrethana që lidhen me këtë objekt dhe blerësit/apo përdoruesit e pasurive. Në datën 14.10.2024, ky shtetas u paraqit dhe dha dëshminë e tij, ku ka deklaruar se kunati i tij, i ndjeri P. U., ka pasur lidhje miqësie me prokurorin Lazer Çardaku dhe se ka ardhur te objekti dhe ka qëndruar për pushime, ndoshta në hotel. Gjatë dëshmisë së tij, pohoi se i njuh pjesën më të madhe të banorëve të këtij objekti, por pasi u njoh me listën e banorëve të bashkëngjitur në denoncimet e depozituara pranë Komisionit, kishte dyshime mbi vërtetësinë e plotë të saj, duke deklaruar se, në dijeninë e tij, Lazer Çardaku nuk ka apartament në pronësi në këtë objekt.

17.4 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, pasi ngriti dyshime të arsyeshme se ka përdorur dhe/apo ka pasur në disponim një pasuri të paluajtshme në objektin e ndërtuar në Velipojë. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti shpjegoi se të paktën dy nga denoncimet janë dërguar nga i njëjti person, për të cilin referon se ka pasur akses të plotë te sistemi i ASHK-së, e në këtë kuptim ka pasur mundësi të verifikojë edhe emrat e pronarëve të objektit në fjalë, duke e lidhur këtë fakt me mundësinë e krijimit prej tij të një liste banorësh realë të këtij pallati, së bashku me emrin e tij, rrethanë kjo e evidentuar edhe nisur nga deklaratimet e dhëna nga shtetasi A. C., i cili ka hedhur dyshime mbi vërtetësinë e kësaj liste. Në vijim, subjekti ka pranuar faktin se ka qëndruar si pushues në këtë objekt për periudhën verore që i përket viteve 2017, 2018 dhe 2019, duke përdorur apartament apo te hoteli në pronësi të shtetasit P. U., për të cilin thotë se ka pasur njohje personale. Pas përgjigjeve të subjektit në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, Komisioni konkludoi se nuk provohet, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, disponimi prej subjektit i kësaj pasurie, por vlerësoi se në kundërshtim

²⁶ Shkresë me nr. {***} prot., datë 01.08.2024, e Komisionit.

²⁷ Shkresë me nr. {***} prot., datë 16.09.2024, e ASHK-SË Drejtoria Vendore Shkodër.

me parashikimet e bëra në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, subjekti nuk është treguar bashkëpunues gjatë procesit të hetimit, duke mos deklaruar përdorimin e kësaj pasurie.

17.5 Në analizë të rrethanave më sipër analizuar, referuar jurisprudencës së Kolegjit²⁸, trupi gjykues vëren se vlerësimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në drejtim të sasisë së informacionit të dhënë dhe nivelit të detajimit të tij i mbart pasojat në vlerësimin e përmbushjes ose jo të barrës së provës nga ana e subjekteve dhe, për rrjedhojë, nuk mund të vlerësohet në dëm të tyre edhe në kuadër të qëndrimit bashkëpunues apo jo ndaj procesit të rivlerësimit kalimtar.

17.6 Përveç sa më sipër, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka përdorur një ambient gjatë pushimeve verore në vitet 2017, 2018 dhe 2019. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë pasuri para plotësimit të deklaratës *vetting*, për t'u konsideruar si pasaktësi në deklarim pikërisht për këtë shkak. Si rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se, duke konsideruar si periudhë që ka përdorur apartamentin vitet 2017, 2018 dhe 2019, në kushtet kur vetë Komisioni nuk ka konkluduar për fshehje të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, kjo pasuri nuk mund t'i nënshtrohet kontrollit në kuadër të këtij procesi, në kushtet kur çdo lloj marrëdhënie e krijuar mes subjektit dhe saj i përket një periudhe që tejkalon periudhën e rivlerësimit. Për më tepër, Komisioni, edhe pasi ka kryer një hetim të thelluar administrativ rreth kësaj pasurie, nuk ka mundur të konkludojë për ndonjë prej shkeljeve të përcaktuara në ligjin nr. 84/2016.

17.7 Trupi gjykues konstaton se mungesa e bashkëpunimit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, e cituar në vendim, nuk i korrespondon ndonjë pasurie të deklaruar në deklaratën *vetting*, por ka shërbyer për të kualifikuar mosdeklarimin gjatë procesit të hetimit administrativ të përdorimit gjatë pushimeve verore 2017-2019, të një apartamenti të ndodhur në Velipojë, Shkodër. Për më tepër, Komisioni nuk ka përcaktuar se çfarë pasuje konkrete do të ketë ky konstatim, për vlerësimin e pasurisë së subjektit. Për rrjedhojë, trupi gjykues i gjeti pa peshë këto konstatime të Komisionit, për sa i përket cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, duke vlerësuar se ato duhet të nënshtrohen kontrollit periodik të pasurisë nga institucionet përgjegjëse në vijim.

18. Për sa më lart, trupi gjykues i Kolegjit mori në shqyrtim problematikat e lidhura me pasurinë apartament banimi, blerë në vitin 1999, të cilat konsistojnë në deklarime të pasakta dhe balancë negative në vlerën prej (-)1.303.360 lekësh, si të vetmet çështje përcaktuese në lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit. Këto problematika të konkluduara nga trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, referuar kohës kur kanë ndodhur, një analize të munguar dokumentare rreth vlerës së transaksionit, e cila referuar, por jo vetëm, rrethanave kohore mund të sugjeronte një vlerë edhe më të ulët se ajo e marrë në analizë, faktin që kjo është pasuria e paluajtshme/banesa e vetme në të cilën vijon të jetojë ende subjekti i rivlerësimit dhe mungesën e problematikave domethënëse gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit 2003-2016, nuk u vlerësuan të mjaftueshme për ta konsideruar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në kuptim të nenit 61, pikat 3 e 5 të ligjit nr. 84/2016.
19. Për vlerësimin e kriterit të kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, sipas vendimit të Komisionit, ka rezultuar se ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr.

²⁸ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 33/2022 (JR), datë 29.07.2022 (A. Xh.).

84/2016 dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

20. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se vendimi nr. 812, datë 08.11.2024, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, nuk është i drejtë dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet, duke vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Lazer Çardaku.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 812, datë 08.11.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Lazer Çardaku.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 28.01.2026.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi - kundër

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Ne gjyqtarët e trupit gjykues Sokol Çomo dhe Albana Shtylla, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kemi votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 812, datë 08.11.2024, që i përket subjektit të rivlerësimit Lazer Çardaku, dhe shkarkimin e tij nga detyra. Ky qëndrim është bazuar në vlerësimin tonë, se subjekti i rivlerësimit, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë për arsytet e mëposhtme.
2. Në shqyrtim të shkaqeve të ankimit dhe, si dhe atyre të administruara në fashikull nga Komisioni, vlerësuam se në tërësinë e tij, vendimi i Komisionit është mbështetur mbi një analizë të drejtë të situatës faktike në raport me ligjin dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, që do të justifikonin ndryshimin e vendimit objekt kontrolli.
3. *Lidhur me pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 73 m²*, si dhe shtesën e ndërtimit me sip. 22.9 m² së bashku me truallin, ndodhur në lagjen “{***}”, Shkodër, Komisioni ka konkluduar se çmimi i përcaktuar në kontratën e shitblerjes së datës 23.08.1999, nuk përfaqëson çmimin real të shitblerjes së dy pasurive objekt vlerësimi. Në këtë kontekst, Komisioni ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën *vetting*, lidhur me çmimin e blerjes së këtyre pasurive, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurive objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
4. Ne, si anëtarë të trupit gjykues në pakicë, çmojmë se Komisioni ka vlerësuar në mënyrë të drejtë rrethanat faktike që lidhen me këtë pasuri, ashtu siç janë pasqyruar në vendimin e tij. Nga analiza e dokumentacionit dhe e provave të administruara gjatë hetimit administrativ, nuk rezultojnë shkaqe që të vënë në dyshim saktësinë e konstatimeve të arritura prej Komisionit.
5. Në gjykimin tonë, arsyetimi i Komisionit është i mbështetur në një analizë të plotë dhe objektive të fakteve, si edhe në një interpretim korrekt të dispozitave ligjore përkatëse. Për këtë arsye, ndajmë të njëjtin qëndrim me konkluzionet e Komisionit për vlerësimin e kësaj pasurie, duke e konsideruar atë të bazuar në prova dhe në ligj, pra subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklaramit të rremë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtyre pasurive, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
6. *Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Golf 5”*, me targë {***}, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting* (datë 26.01.2017), provohet nga aktet e administruara, se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur kanë pasur në përdorim automjetin në fjalë, situatë kjo që e çon në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe/apo personat e lidhur janë në shkelje të detyrimit të deklaramit sipas nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, lidhur me pasuritë në përdorim. Në përfundim të analizës, Komisionit i rezultoi se në lidhje me mosdeklaramin e përdorimit të automjetit në fjalë, subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të paplotë të pasurisë në përdorim, në kundërshtim me sa parashikohet në nenin D,

pika 1 e Aneksit të Kushtetutës. Ne, anëtarët në pakicë, vlerësojmë se Komisioni ka konstatuar drejtë situatën faktike lidhur me këtë pasuri, bazuar në një analizë të plotë dhe objektive të provave të administruara, për rrjedhojë, jemi dakord edhe me konkluzionin përfundimtar të Komisionit për vlerësimin e kësaj pasurie.

7. *Lidhur me pasurinë automjet tip “Volkswagen Lupo”, me targë {***}, të regjistruar në emër të djalit të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konkluduar se ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Edhe për këtë pasuri vlerësojmë se Komisioni ka kryer një vlerësim të drejtë, të plotë dhe objektiv të situatës faktike, duke u mbështetur në provat dhe dokumentacionin e administruar gjatë procesit administrativ. Në vlerësimin tonë, analiza e kryer nga Komisioni është në përputhje me situatën faktike të konstatuar, për rrjedhojë, ndajmë të njëjtin qëndrim edhe për sa i përket konkluzionit përfundimtar të Komisionit mbi vlerësimin e kësaj pasurie, duke e konsideruar atë të bazuar në fakte dhe në ligj.*
8. Në përfundim, në analizë të qëndrimeve të mësipërme, për shkak të problematikave që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësojmë se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë arrijmë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Lazer Çardaku, nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, sipas nenit 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, për këtë arsye, kemi votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të këtij subjekti rivlerësimi.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi